



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

---

Datë: 17.03.2021

**Pyetjet nga Aplikantët/Përgjigjiet nga MZHR-ja lidhur me PZHRB 2021 dhe Programi për Rimëkëmbje Ekonomike Masa 15**

1. Unë kam përfitu grant nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, gjatë vitit 2019, a kualifikohem të aplikoj për grantin sipas thirrjes "Skema e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 (Lot II), Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR).
  - **PO, por do të kontrollohet se a është në përputhje me RREGULLORE (QRK) -Nr. 04/2020 PËR NDIHMËN DE MINIMIS.**
2. Deshta me apliku në eKosova po që sistemi nuk po i pranon dokumentet në formën e kërkuar nga sistemi gjegjësisht në JPG edhe PNG ju lutem kam ngarku në JPG edhe PNG nuk po pranon edhe njejtën kohë kam bërë video si dëshmi për situatën e cila është edhe në këtë kohë ende vazhdon, që mundeni me ma dërgu një numër të telefonit mobil do të ju sjelli 2 video në të dy verzionet për dokumentet kom bo po që për fat të keq ende nuk kom mujtë me apliku pres me shprese se kërkesës sime do ti pergjigjeni pozitivisht.
  - **Dokumentet duhet të jenë me dukshmëri të qartë dhe të formatit PDF.**
  - **Për sqarime lidhur me portalin ekosova ju lutem drejtohuni me email tek [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net) ose mund të vini në MZHR për sqarime shtesë.**
3. Deshtem te ju pyesim, në lidhje me Skemën e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar “PZHRB 2021, a kualifikohemi nese aplikojm për pajisje të përpunimit të qumshtit?
  - **Lexo Udhëzuesin dhe Kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht piken 2.4.**

4. Po ju shkruajmë lidhur me Skemen e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021 “Masa 15 (Lot II dhe Lot III), saktësisht Lot III. Kemi disa pyetje lidhur me këtë thirrje në fjalë, të cilat i gjeni të listuara me poshtë:

Sipas pikës 2.1 (Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?) të UDHËZUESIT DHE KRITEREVE PËR APLIKANTËT E GRANTEVE MZHR/2021, thuhet se aplikuesi duhet të jetë shtetas i Kosovës. Në këtë rast aplikues a nënkupton pronarin e kompanisë apo vetëm personi i cili aplikon në emër të kompanisë, që mund të jetë menaxheri i përgjithëm apo ndonjë pozitë tjetër menaxhuese?

- **Pronari sikur edhe aplikanti duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, I autorizuari duhet të bashkangjese autorizimin. (shih pikën 3.2. të udhëuesit për aplikantë).**

5. Në udhëzuesin e lartëshënuar specifikohet që përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë nga 10% deri në 40%. Si përcaktohet përqindja e bashkëfinancimit, në bazë të shumës së kërkuar apo ka ndonjë kriter tjetër?

- **Përqindja përcaktohet në bazë të shumës/buxhetit të përgjithshme të Projekt Propozimit.**

6. Tek pika 2.6 (Llojet e veprimit/projektit), në udhëzim kategorizohen 3 veprimtari të cilat janë të kualifikueshme sipas thirrjes. A mund të aplikojmë vetëm për një të kategori, psh. investimi në makineri?

- **Një biznes apo individ ka të drejtë të aplikoj vetëm një herë, pra ju mund të aplikoni në kategorinë ku i plotësoni kriteret bazuar në Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve.**

7. Deshta me u informur dhe të pyes për PZHRB 2021. Ideja është për themelimin e një startup me bazë në Kosovë për digital marketing agency që fillimisht i ka klientet në Kosovë, por e ka synimin për klientet jashtë vendit si Gjermani, Zvicër etj. Biznesi i yne ka dy themelues dhe njeri është me shtetësi të Kosovës kurse tjetri me shtetësi të Gjermanisë (nuk është shtetas i Kosovës). Pyetja ime është: A na përjashton kjo neve për aplikimin e grantit “Start up” Loti 1?

- **Pika 1.2 e Udhëzuesit thotë: Për t'u kualifikuar për grant, aplikantët duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.**

8. Lot 1 Start-up

Kohëzgjatja: Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë 6 muaj (përveq nëse ndryshe parashihet me kushtet kontratë). Ju lutem mund të me sqaroni më saktë se çka nënkuptoni me fjalinë më lartë? Projekti të ketë jetëgjatësi vetëm 6 muaj (Startup-i) apo implementimi i atij granti të mbaroj për 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës?

- **Implementimi i projektit që nga data e nënshkrimit të kontratës në mes MZHR-së dhe përfituesit është periudhë 6 mujore, kjo nuk ka të bëjë fare me jetëgjatësinë e projektit, por monitorimi vazhdon nga MZHR pas implementimit.**

9. Nëse parashihet që Startup-i të fillojë në vitin 2022 ( të hapet biznesi), por planifikimi dhe gjenerimi i të hollave është i nevojshëm qysh tani ( si me rastin e fitimit të këtij granti në 2021), a është i lejuar aplikimi në këtë grant të 2021-tës?

- **Nuk parashihet fillimi në vitin 2022, të gjitha procedurat parashihen të përfundojnë 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës.**

10. Duke u bazuar në udhëzuesin për aplikantët e granteve po ju drejtohem rreth nevojës për sqarim e cila ka të bëjë me dëshirën time për të aplikuar për LOT 1 Start-up. Pyetja si më poshtë:

Pika 2.1 Kualifikimi i aplikanteve: kush mund të aplikojë?

Ju lutem a mund të më tregoni se cilat nga këto pika që gjenden në udhëzues vlejné për LOT 1 Start-up?

-Të jenë shtetas të Kosovës.

-Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% private (sipas definicionit të Kosovës) regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës.

-Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë (apo likuiditetin potencial);

-Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e pranimit të grantit;

-Të mund të demonstrojë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur;

-Të jetë drejtëpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve.

- **Të gjitha këto pika vlejné për Startup**

11. Ne jemi Firma METALMONT, Gjilan e cila mirret me shitjen me pakicë e materialëve elektrike, ujësllësit, kanalizimit dhe ngjyrave të ndryshme, Unë në websajt të Komunes së Gjilant e shkarkova materialin për Grant në kuader të Rimekembjes ekonomike. Ne si firmë apo biznes na intereson se a kemi të drejtë me për të aplikuar për grantin në fjalë, meqenëse nuk jemi biznes Start-up apo fillestar, por jemi biznes që operojmë që 25 vite. Poashtu provuam për të hyrë në faqën zyrtare të MZHR-së që e keni shkruar në materialin – Udhëzues për grante por nuk ka qasje. Pyetja është se cilat janë procedurat e aplikimit nëse dhe ne i plotësojmë kushtet si biznes.

- **Pika 2.4 e Udhëzuesit thotë: Tregtia (me pakicë e shumicë), nuk kualifikohen.**

- Websajti është funksional gjatë gjithë kohës, shih linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>

12. Kam një pyetje rreth aplikimit për grante në MZHR. Pas aplikimit dhe përfundimit të projektit më doli linku që përmban raportin. Në raport është projekti në tërësi përpos dokumenteve që kam ngarkuar. Si mund të kem dëshmi që i kam ngarkuar të gjitha dokumentet në rregull?

- Ju mund të kërkonti sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net)

13. Përshëndetje luteni që të më njofotni si llogariten se cilat janë kriteret e vlerësimit dhe forma e tyre për Start-Up.

- Lexo Udhëzuesin dhe Kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 4.

14. Jam duke aplikuar për grant për Lot1 për biznese të vogla dhe mikro për shumën deri 5000 € tek pjesa si në foto tek organi implementues. Pyetja është se a duhet të e cekim emrin e biznesit tonë apo të Ministrisë, të cilën gjë e ke të bashkangjitur si në foto.

V. PLANI I VEPRIMIT

Fshije aplikimin

Aktiviteti	MUAJI 1	MUAJI 2	MUAJI 3	MUAJI 4	MUAJI 5	MUAJI 6	Organi implementues
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...

- Fshij rresht + Shtoj rresht

- Varet kush është organi implementues sipas projekt-propozimit tuaj.

15. Në web faqen e konkursit për Grante për START UP ishte e cekur se deri më datë 15.03.2021 mund të bëjmë pyetje, dhe pasi une pash projektin tani u desht që të bëj pyetje në ditën e fundit. Faleminderit nëse gjeni kohë për pergjigjen time. Per grantin START UP desha të pyes se a mund të aplikoj si një qytetare dhe jo si një biznes për grande për të hapur biznes në rast që përzgjedhem për këtë grant? apo patjetër duhet që të kem biznesin e regjistruar?

- **Të interesuarit për aplikim në kategorin Startup aplikojn si qytetar.**

16. Në udhëzim thuhet që çdo dokumente të futet në rubriken e vetë, në të kundërtën refuzohet projekti! Mirëpo tek përshkrimi tek LOT 1, tek rubrika 1, Përshkrimi është Oferta për makineri/paisje dhe shërbime ndërsa tek LOT 3, Përshkrimi është oferta për makineri dhe paisje, nuk përshkruhet se në njëjtën rubrik duhet të vendoset edhe Oferta për shërbime nëse kemi.

A pranohet nëse shtojm një rubrikë dhe vendosim ofertën për shërbime ndaras nga ajo për Makineri dhe Paisje.

- **Mund të fusni si një dokument PDF ofertën për makineri dhe shërbime por mund të jenë edhe ndaras si dy oferta.**

17. Tek Udhëzimi tek lista e dokumentave tek LOT 2 dhe LOT 3, nuk kërkohet vërtetimi tatimor, ndërsa rubrika është për këtë dokument, a duhet gjithësesi të jetë vërtetimi tatimor dhe nëse ka marrëveshje me ATK, a është dokument i pranuar!

- **Vërtetimi tatimor në këtë fazë nuk është i domosdoshëm për aplikantët e PRE M15 (Lot 2 dhe Lot 3).**
- **Nëse pronari/biznesi është në marrëveshje me ATK është dokument i pranuar nga ana e MZHR-së. Kjo vlen për aplikantët e PZHRB 2021 (Lot 1).**

18. Quhem ?????, kam një restaurant të vogël peshku, deshta mu informu a kam të drejtë aplikimi për grant në masën 15 lot 1 për mikro-biznese. Nuk jam përfituese e masës 4 përkrahje e femrave në biznes.

- **Lexo udhëzuesin Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve, sepse thirrja e MZHR-së lidhur me PRE Masa 15 nuk ka paraparë Lot 1, kurse sa i përket Masës 4 nuk ndërlidhet me thirrjet e MZHR-së.**

19. Pako aplikimi për Lot 1 Startup si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen:  
Shtojca A1 Formulari i aplikimit PZHRB 2021 (plotësohet vetëm online përmes <https://ekosovacms.rks-gov.net/> (online pasi që e hapa llogarinë, po e hapë dritaren me shtojcën A me pyetjet për aplikim, mirëpo a ka ndonjë formular tjetër ku duhet të buxhetohet ideja e startup)?
- **Projekt Propozimi sikur edhe Buxheti plotësohen vetëm online.**
20. Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti PZHRB 2021; - Kjo po besoj që pas plotesimit të pyetjeve të shtojcës A, hapet si opsion për të ngarkuar këtë dokument dhe tjerat dokumentet shtese që kerkohen?
- **Shtojca C1 Deklarata me shkrim nga aplikanti PZHRB 2021 shkarkohet nga aplikanti, plotësohet dhe si e tillë në formatin PDF si dokument vendoset në follderin përkatës.**
21. Dokumentet tjera shtesë: Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit duhet të ketë përputhje të plotë me shumën totale të buxhetit. (oferta duhet të përmbajë të dhënat e sakta të ofertuesit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime). - I gjithë buxheti i projektit duhet të jete sa ofertat për pajisjet dhe shërbimet e planifikuara?
- **Gjithsesi.**
22. Psh nëse i gjithë projekti ka të bëjë me: blerje të pajisjeve, trajnime profesionale lidhur me pajisjet, zhvillim webi, a duhet që i gjithë projekti të jetë vetëm në vlerë në bazë të ofertave të pajisjeve/trajnimeve/zhvillimit të webit?
- **Buxheti i Projekt Propozimit duhet të mbulohet në plotëni me oferta për pajisje, makineri, trajnime, marketing etj. D.m.th. për çdo shpenzim të paraparë në buxhet, aplikanti duhet të ketë mbulueshmëri me ofertë.**
23. Pasi aplikimi do të bëhet për Start up, numri i të punësuarve me shumë gjasë do të jetë vetëm një dhe pasi thirrja nuk mbulon paga për punëtorë të rinjë, a mundet ky element të penalizojë një ide në këtë aspekt? Apo mendohet të shtohet nr. i të punësuarve nëse brenda këtyre 6 muajve vetëm gjenerohen të ardhura dhe duhet të llogaritet nr. i të punësuarve gjatë këtyre 6 muajve?
- **Numri i të punësuarve duhet të evidentohet në Projekt Propozim, por nuk është kriter penalizues.**

24. Po u shkruaj në lidhje me shpalljen e fundit që ka bërë MZHR në lidhje me grantet për Start-up. Kam lexuar udhëzuesin nga web faqja e MZHR, por nuk kam arritur të kuptoj nëse kualifikohen për mbështetje nga granti shpenzimet në lidhje me Trajnimin/Shkollimin, psh. të kurseve speciale si për Kontabilist apo kurset speciale për floktarë. Gjithashtu dua të di nëse mbulohen edhe shpenzimet e kostos për renovimin dhe përgatitjen e hapësirës së punës (punët për instalime elektrike, mure ndarëse etj.) të lokalit ku do të kryhet veprimtaria e biznesit!

- **Lexo kostot e kualifikueshme dhe të pakualifikueshme tek pika 2.7 e Udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve.**

25. Jam ????, Drejtor në ???? Sh.P.K. Po ju shkruaj për një pyetje rreth granteve për biznese të ofruara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Te kategorizimi në LOT, në bazë të buxhetit, ???? Sh.P.K futet te LOT 3, pasi të hyrat në vitin 2020 e kalojnë shumën e 15,000 Euro.

Mirëpo te numri i punëtorëve, ne kemi vetem 4 punëtor, e që sipas udhëzuesit i takojmë LOT 2. A mund të më udhëzoni në cilin LOT duhet të aplikojmë?

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 e jo nr. i punëtorëve të ndërmarrjeve Mikro dhe të vogla. Në rastin konkret ndërmarrja me qarkullimin mbi 15,001.00 € me nr. prej 4 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 3.**

26. Kërkoj ndihmën e juaj lidhur me skemën "Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar". A mund të aplikojmë ne si biznes ekzistues Kopsht i fëmijëve?

- **Sigurisht që mundeni!**

27. Kam disa pyetje rreth financimit të pajisjeve për biznese. Biznesi ka veprimtari fermë të lopëve - qumështore dhe kërkesa për grant është sistemi i mjeljes që ka vlerë rreth 23,000 Euro për 50 lopë qumështore. A financohet kjo pajisje - Linja e prodhimit te djathit?

- **Lexo Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 2.4 nënpika 3 thotë: Bujqësia (përfshijmë pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) nuk kualifikohet.**

28. Nëse biznesi është kafiteri apo restaurant a financohet për blerje të pajisjeve, psh. furra për pica, skarë, frigorifer, karrika dhe tavolina ?

- **Gastronomia është sektor i kualifikueshëm kurse sa i përket pajisjeve ju lutem lexojeni Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 2.4.**

29. Restoranti i peshkut ku njëkohësisht është edhe vetkultivues i peshkut, a financohet nëse aplikojmë për pajisje për kultivim të peshkut?

- **Gastronomia është sektor i kualifikueshëm kurse sa i përket pajisjeve ju lutem lexojeni Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 2.4. dhe 2.6. Kurse Bujqësia (përfshirë pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) nuk kualifikohet.**

30. Nëse kompania është shërbyese dhe mirret me kontabilitet, a financohet për blerje të kompjuterëve, laptopëve dhe softuerave që shërbejnë për shërbim të klientëve?

- **Spektori i shërbimeve është i kualifikueshëm sikur edhe TI.**

31. Kompanitë që merren me instalime të ujit, kanalizimit dhe nxemjeve, a janë të pranueshme në kategorinë e shërbimeve apo konsiderohen tek kategoria e ndërtimitarisë?

- **Ju lutem lexojeni Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 2.4. dhe 2.6!**

32. Kisha një pyetje rreth granteve PZHRB meqenëse nuk po mund të gjej përgjigje tek udhëzuesi. Si kategorizohen bizneset start-up dhe ato ekzistuese? Për shembull, biznesi me të cilin unë dua të aplikoj është i regjistruar në ARBK por nuk ka pasur të ardhura dhe i ka më pak se 1 vit që është regjistruar. A do të kategorizohet ky biznes ende si 'start-up' apo do të duhet të ishte 'biznes ekzistues'?

- **Biznesi i regjistruar në ARBK është biznes ekzistues.**

33. Nuk po vjen kodi në telefonin tonë edhe pse e kërkuam disa herë.

- **Ju mund të kërkoni sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkese drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net).**

34. Mundësisht një sqarim lidhur me kërkesën për grant për bizneset ekzistuese. A mundem të aplikoj në zgjerimin e biznesit për pajisjet me kompjutera ( Laptop ) dhe Printer për trajnimin /punësimin e të rinjve në lëminë e Kontabilitetit?

- **Spektori i shërbimeve është i kualifikueshëm sikur edhe TI.**



35. Ndërmarrja prodhuese "???", ??? ???? B.I. Pyetja ime është kjo: unë kam aplikuar për regjistrim për grante nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, programi për rimëkëmbje ekonomike 2021 masa 15 në platformën eKosova, kam ngakuar dokumentet siç kërkohej - letërnjoftimin para, prapa dhe një foto me letërnjoftim si dhe foton e certifikatës së regjistrimit ndërsa pasiqë vet jam pronar nuk kam pasur nevoj për autorizim. Pas disa dite më ka ardhur sms "shërbim i nivelit 1 (shërbimet që nuk kërkohej verifikim identiteti)" ndërsa pas disa ditësh më ka ardhur një tjetër sms "refuzim i dokumenteve të identitetit" dhe po në të njëjtin njoftim: "ju njoftojmë se identiteti i juaj i paraqitur përmes dokumenteve, gjatë procesit të regjistrimit në eKosova është verifikuar me sukses Urime" dhe niveli i verifikimit ka mbetur në 1. Poashtu mua më lejohet qasje në sistem dhe në opsionin "grante dhe subvencione" dhe përgatitja e aplikimit ku pas ruajtjes në draft më vjen një sms: konfirmimi i aplikacionit "është pranuar si draft...". Çfarë më sugjeroni të bëj të aplikoj me këtë nivel verifikimi apo të krijojë një llogari të re? Ndoshta arsyeja për këtë mos verifikim ka ardhur për shkak që unë letërnjoftimin e kam nxjerrur në vitin 2018 dhe ndoshta kam ndryshuar që atëherë pak nga fotoja që është në letërnjoftim.

- **Ju mund të kërkonit sqarime përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net).**

36. I nderuar, nuk po funksionon linku <https://ekosova.rks-gov.net/>. Si mund të qasem për Skemën e Grantëve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2021(Lot 1 Start-up)? Po pres pak ndihmë në lidhje me këtë.

- **Linku <https://ekosova.rks-gov.net/> sikur edhe linku <https://ekosova.rks-gov.net/Security> funksionojnë pa problem.**

37. Gjatë aplikimit në eKosova, duke e testuar deri në fund për me e shiqu se cilat dokumente kërkohej, kam aplikuar padashje. Kam bërë kërkesë për rihapje të aplikimit eKosova me datë 08.03.2021.

- **Ju mund të kërkonit sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net)**

38. Jam ??? ??? dhe desha të marrë një informacion nga ju. Kompania ime është kompani shumë e re - Start-up dhe është regjistruar në muajin Tetor të vitit 2020. Aktivitetet e saj janë në fushën e automatizimit Industrial dhe prodhimit të makinave. Por, deri më tani kompania nuk ka bërë asnjë qarkullim financiar dhe është ende në fazat e para. Pyetja është: a kam të drejtë të aplikoj në Lotin 1, pra për Start-up apo jo?

- **Biznesi i regjistruar në ARBK është biznes ekzistues.**

39. Në momentin e regjistrimit në sistemin eKosova, nëse je biznes kërkohet të bashkangjiten të dhenat e biznesit, mirëpo si foto mund të ngarkosh vetem faqen kryesore të biznesit por jo edhe informatat përcjellese. A mjafton ngarkimi vetëm i faqes së parë!

- **Komplet Certifikaten e Biznesit me fletët përcjellese mund t'i fusni si një dokument PDF.**

40. Tek hapi tjetër kërkohet autorizimi, si të veprohet në këtë rast nëse në biznes Pronar, Drejtor dhe Person i autorizuar është një person dhe është aplikues në rastin konkret? A mjafton të bashkangjitet informata në faqen 5 që është pjesë e Certifikates së Biznesit në të cilën tregohen personat e autorizuar, apo duhet të krijohet një dokument i veçantë si autorizim?

- **Mund t'i fusni të dhënat sikur tek rasti i pronarit ose vetëm faqen 5 të certifikates së biznesit.**

41. Dëshiroj të parashtroj pyetjet në vijim në lidhje me skemën e granteve "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" Masa 15 (Lot II dhe Lot III). Kjo pyetje ka të bëjë nëse ka ndërlidhje në mes të QARKULLIMIT VJETOR dhe NUMRIT TË PUNËTORËVE? Përshembull: për LOT 2 kërkohet qarkullim minimum 7,001.00€ deri në 15,000.00 € të dëshmuara/deklaruar në ATK për vitin e fundit fiskal (2020). Çka nëse një kompani aplikuese ka 3 punëtorë (dmth ndërmarrje MIKRO) dhe qarkullimin e ka mbi 15,000 EUR (le të themi përshembull: ka qarkullim 53,500 EUR)?

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 e nr. i punëtorëve të ndërmarrjeve Mikro dhe të vogla duhet të jetë sipas kriterëve të përcaktuar për këto ndërmarrje, në rastin konkret ndërmarrja me nr. prej 3 punëtorëve ka të drejtë të aplikojë në Lot 3.**

42. Kjo pyetje ka të bëjë me maksimumin e qarkullimit vjetor: çka nëse një kompani ka mbi 500,000 EUR qarkullim vjetor? Në këtë rast, a ka të drejtë aplikimi për LOT 3 apo lejohet aplikimi vetëm për kompani që kanë më pak (dmth maksimum) 500,000 EUR qarkullim vjetor?

- **Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve tek pika 1.4 për aplikim në Lot 3 kanë përcaktuar se qarkullimi maksimal për vitin 2020 mund të jetë deri në 500,000.00 €.**

43. Tek pika 2.4 Sektorët apo Temat ju flisni që interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet ose të krijojnë eksporte - ndërsa tek pika 4. Kriteret e Vlerësimit (elementet e notimit) askund nuk përmendet zëvendësimi i importeve, respektivisht potenciali për eksport.

- **Këto kritere kanë edhe nënkategori në rastin konkret relevanca e veprimit si dhe efektshmëria dhe arritshmëria.**

44. Në Udhëzuesin dhe Kriteret për Aplikant, konkretisht në faqen 9 - ju flisni për procesin e vlerësimit përmbajtësor. Pyetja është: si do të konsiderohet që aplikacioni demonstroi që ndermarrja ka perspektivë të mirë të të qenurit e suksesshme dhe e qëndrueshme dhe si do të vlerësohet që implementimi i një aplikacioni (projekti) do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të Skemes së Grantëve për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës? Ju lutem, nëse ka mundësi ta definoni këtë pjesë SHUMË MIRË, sepse duket shumë subjektive dhe rrjedhimisht sipas mendimit tim, nuk ofron bazë për 100% objektivitet (transparencë)!

- **Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse japin mundësi për të dhënë informata të mjaftueshme për vlerësuesin nëse ato plotësohen drejtë dhe në mënyrën e duhur.**

45. Duke shfletuar faqen e ministrisë suaj, në lidhje me skemat e kaluara të aplikimit për grante për biznese (Përshembull: **Programi për Rimëkëmbje Ekonomike 2020, Masa 8** ose **Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2020**), vërehet që gjatë shpalljes së rezultateve (qoftë të listës përfituese, qoftë të listës rezervë ose të listës refuzuese) vendoset VETËM NUMRI PROTOKOLIT / NUMRI APLIKUES, por jo edhe emri i kompanisë / ndermarrjes. Ju lutem a ka mundësi që NË SKEMËN E TANISHME KUR TË SHPALLEN REZULTATET të vendoset edhe emri i kompanisë, sidomos emri/at e kompanive në listën përfituese (dmth jo vetëm numri i protokolit aplikues), sepse vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie e plotë? Fundja, fondet janë publike, prandaj edhe lista e përfituesve finale do të duhej të ishte publike (pa rezervim të privatësisë).

- **Procesi me përfituesit është transparent në MZHR, por me publikimin e rezultateve preliminare nuk përfundon vlerësimi, është edhe faza e tretë e verifikimit. Parakualifikimi nuk nënkupton dhënie të kontratës. Nënshkrimi i kontratave në MZHR bëhet në mënyrë publike edhe me prezencë të mediave.**

46. Në fund të pikës 4. Kriteret e Vlerësimit, potencohet që pjesë e vlerësimit do të jetë edhe një anëtar i shoqërisë civile në cilesinë e vëzhguesit për skemën "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" Masa 15 (Lot II dhe Lot III). Pyetja konkrete është: a mund ta bëni publik emrin e personit nga shoqëria civile ose mediat ju lutem, sepse vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet transparencë e plotë 100%?

- **MZHR do të sigurojë transparencë të mjaftueshme të procesit të vlerësimit.**

47. Për qëllim të transparencës dhe llogaridhënies - a mund të bëhet publik edhe paneli juaj vlerësues ju lutem? Njejtë si në pyetjen më lartë me vëzhguesin e shoqërisë civile, edhe bërja publike e panelit vlerësues të propozimeve do të kontribuonte në krijimin e bindjes që procesi është i fer, ka transparencë të plotë dhe llogaridhënie 100%?

- **Sikur në të kaluarën edhe tani MZHR me rastin e përmbylljes së procesit i bënë njoftimet ku aplikantët kanë mundësi t'i drejtohen komisionit të ankesave ku përveç përgjigjes me shkrim kanë mundësi të vijnë në MZHR dhe me prezencë të komisionit të merr sqarimet e nevojshme.**

48. Kriteret e Vlerësimit, pika 4: ju lutem sqaroni më DETAJISHT se si planifikoni të bëhet vlerësimi / poentimi me pike në këto pjesë: 1. Kapaciteti financiar dhe operacional 30 pikë, 2. Relevanca e veprimit 20 pikë, 3. Efektshmëria dhe arritshmëria 15 pikë, 4. Qëndrueshmëria e veprimit 20 pikë dhe 5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto 15 pikë. Duke hulumtuar praktikatat më të mira të vlerësimit fer, transparent dhe real të projekt propozimeve në BE, mund të vërehet që për secilën nga 5 titujt e poentimit që ju keni theksuar, ka të paktën 5 deri në 10 nën-titujt në të cilat do të duhej të bazohet poentimi i propozimeve nga paneli juaj. Me fjalë të tjera - ajo çfarë dëshiroj të ngreh si shqetësim është: çka konkretisht e bën një propozim për shembull t'i marrë vetëm 10 pikë, një tjetër propozim 21 pikë dhe një tjetër t'i marrë 30 pikë tek pjesa e poentimit të 1. Kapaciteti financiar dhe operacional, të ciles ju i'a keni alokuar 30 pikë maksimale? Prandaj, ju lutem që t'i specifikoni sa më detajisht se çka / si / sa do të vlerësohet secila nga këto pika: 1. Kapaciteti financiar dhe operacional 30 pikë, 2. Relevanca e veprimit 20 pikë, 3. Efektshmëria dhe arritshmëria 15 pikë, 4. Qëndrueshmëria e veprimit 20 pikë dhe 5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto 15 pikë. Ofrimi përgjigjes / sqarimit tuaj sa më të saktë në këtë pyetje, jo vetëm që do të siguronte vlerësim 100% fer, real, transparent dhe me llogaridhënie të aplikimeve, por gjithashtu do të siguronte që secili aplikues potencial ta përgadisë aplikacionin e saj / tij sa më mirë dhe më komplet që është e mundur.

- **Secila nga pesë kategoritë e vlerësimit është e ndërlidhur me pyetjet në aplikacion, planin e veprimit dhe buxhetin e prezantuar nga aplikuesi.**

49. Dhe pyetja e fundit por më e rëndësishmja: tek pjesa 5 Ankesat - në rast se një aplikues dorëzon ankesë, dhe pas shqyrtimit të ankesës nga institucioni juaj, aplikuesit i kthehet përgjigje ndaj ankesës që ka bërë. Pastaj, në rast se aplikuesi prapë nuk është i kënaqur me përgjigjen e ankesës së parë që merr nga institucioni juaj, në cilën instancë tjetër mund të bëjë ankesë të dytë?

- **Në rast se aplikuesi nuk është i kënaqur me përgjigjen, mund të vijë në MZHR dhe të jepen sqarime shtesë në prani të komisionit. Nëse edhe kjo nuk është e mjaftueshme për aplikantin atëherë mund t'i drejtohet instancave më të larta siç shpjegohet në këshillën juridike.**

50. Kam nevojë për një sqarim në lidhje me udhëzuesin për aplikantë tek pjesa 2.1 Kualifikimi i aplikantëve ku ceket paragrafi: të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara para aplikimit për grant. Pyetja ime është kjo: Nëse një biznes i cili ka pasur për aktivitet tregtinë dhe i takon Lotit III, tani dëshiron të zgjerojë aktivitetin e tij në

përpunim të ushqimit dhe e regjistron/shton këtë aktivitet në të njejtin biznes para se të aplikojë për grant, a kualifikohet për aplikim?

- **Bizneset me veprimtaritë e tyre bazuar në pikën 2.4. të udhëzuesit për aplikantë sikur edhe qarkullimi vjetor i vitit 2020 dhe numri i punëtorëve janë përcaktues për aplikim në Lot specifik.**

51. Sa i perket thirrjes suaj Skema e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 , Loti 2 kërkoj të më njoftoni se gjatë aplikimit a duhet të përpilohet plani i biznesit për ndërmarrjen prodhuese që ka synim të blejë një pajisje në prodhimin e mobileve.

- **Secili Projekt Propozim duhet të plotësojë vetëm Aplikacionin dhe dokumentet e përkruara me këtë thirrje për propozime.**

52. Në lidhje me thirrjen për Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2021 (Lot 1 Start-up dhe Lot 1 biznes ekzistues) ne kemi biznesin e themeluar në 2019 por për shkak të pandemisë në vitin 2020 e kishim shumë të vështirë operimin si biznes siç kishim planifikuar. Të hyrat e vetme që kishim gjatë vitit 2020 janë mjetet që kemi fituar përmes një granti nga Ministria e Inovacionit dhe Ndermarrësisë prandaj pyetja jonë në lidhje me këtë është: a mund të llogariten këto mjete si qarkullim brenda vitit 2020, rrjedhimisht a na lejohet të aplikojmë me Lot 1 si biznes ekzistues?

- **Qarkullimi dëshmohet me dokument zyrtar (vertetim për qarkullimin vjetor të v.2020) nga ATK, ky dokument kërkohet në fazën e verifikimit.**

53. Pyetja në lidhje me thirrjen e granteve PZHRB 2021, Lot 1 biznes ekzistues, certifikata e biznesit a duhet të jetë e këtij viti apo mundem edhe me të vitit 2020?

- **Certifikata e biznesit mund të jetë edhe e viteve paraprake.**

54. Jemi të interesuar për Aplikim në MZHR por se me çfarë kemi të drejtë aplikimi ne si kopsht e që kemi nevojë për këto produkte si:

- Lojra të jashtme (Oborr si: Trambulin, Topogan, Luhaja ... etj)
- Dhomë ditore - binë në hapsirën jashtë objektit (në oborr)
- Mjete teknologjike si: TV, LAPTOP, PROJEKTOR, ZERIM, PRINTER-SCANNER-COPY.
- Pajisje si: Enë-Larëse, Invertor për ngrohje
- Reklamim si: Rrjetet sociale, vizitkarta, flamuj me logo kopshti, tapeta muri me figura)

Ju lutemi na e jepni një informatë se me cilat mjete mundemi të aplikojmë në këtë skemë për t'u pajisur (për të ekzistuar si biznes)?

- **Shih udhëzuesin për aplikantë pika 2.4, 2.6 dhe 2.7.**

55. Lidhur me aplikimin për start UP, a mund të futet në kalkulim të buxhetit edhe qeraja?

- **Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve konkretisht pika 2.7 qeraja llogaritet si kosto e pakualifikueshme.**

56. Jam në proces të përpilimit të dokumenteve për thirrjen e granteve të publikuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. Gjatë regjistrimit në platformën E KOSOVA, ndër dokumentet e kërkuara është edhe një dokument "AUTORIZIM" a mund të më sqaroni se për çfarë autorizimi bëhet fjalë pasi kompania ime është e regjistruar si SHPK dhe unë jam Pronar i 100% aksioneve dhe unë jam duke e kryer aplikimin? Ju lutem më sqaroni se për çfarë autorizimi bëhet fjalë!

- **Kjo vlenë vetëm për rastet kur aplikon i autorizuari.**

57. I kisha disa pyetje rreth projektit LOT1 Startup: Te pyetja "Përshkruani në detaje makineritë/pajisjet që ju duhen në këtë projekt?" a duhet të përfshihet çmimi i këtyre pajisjeve apo vetëm pajisjet?

- **Oferta duhet të përmbaj të dhëna të sakta për makinerinë, pajisjet, çmimin, ofertuesin etj. Lexo pikën 3.1, nën-pikën Oferta.**

58. Ku duhet me i bashkangjitë dokumentet shtesë, p.sh. ofertat sepse te sistemi online nuk e ka mundësinë e bashkëngjitjes së dokumenteve?

- **Oferta duhet të vendoset në folderin përkatës (sipas emërimit).**

59. A duhet të përfshihet oferta e marketingut te dokumentet shtesë?

- **Oferta mund të vendoset në folderin përkatës (sipas emërimit) si dokument PDF.**

60. A duhet të shtohet ndonjë dokument shtesë i cili tregon sa është shuma që investon MZHR në këtë projekt e sa është shuma e cila do të investoj unë se nuk është e qartë kjo pjesë?

- **Me rastin e plotësimit online të buxhetit e përcaktoni shumën e kërkuar nga MZHR dhe shumën e bashkëfinancimit tuaj si aplikant. Kjo qartë përshkruhet në pikën 1.5 të Udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve.**

61. Nëse bën edhe ndonjë sqarim shtesë për pyetjen “Përshkruani ndikimin e mbështetjes financiare në punësim, numrin e vendeve të punës, lëminë, kualifikimin dhe specifikat tjera të nevojshme!

- **Ju si aplikant hartoni dhe përshkruani në detaje planin e biznesit ku renditni edhe rëndësinë e mbështetjes financiare nga MZHR, vendet e reja të punës, lëminë, kualifikimet, dhe specifikat tjera që ju i parashihni.**

62. Kemi disa probleme gjatë aplikimit. Nuk e kemi përfunduar aplikimin mirëpo na u ka pamundësuar qasja. Figuron që aplikimi është përfunduar dhe gjendet në statusin DRAFT. (Ka edhe tri skanime te faqes per aplikim)

- **Dokumenti në DRAFT mund të rihapet dhe të vazhdohet plotësimi i aplikacionit deri në përfudimin e tij.**

63. Jemi duke i interesuar për të aplikuar në grantin e hapur nga MZHR përmes platformës eKosova, dhe kjo është hera e parë që po përgaditemi të aplikojmë. Ne jemi të interesuar të aplikojmë për pajisje elektronike që na duhen për punën tonë si gazetar në media. Në këtë rast sipas një planifikimi që ne kemi bërë, maksimumi i shumës që na duhen për të blerë pajisjet tona si: kamera, mikrofon, pc, shkon në shumën maksimale 5.000 euro.

**Pyetja 1.** Na intereson të dijmë veçanërisht, sa është shuma e bashkëfinancimit nga ana jonë, nëse në këtë rast kërkohen nga granti maksimum 5.000 euro për blerjen e pajisjeve tona elektronike ( aty ceket nga 10% deri në 40%, në cilin rast është 10% bashkëfinancimit)

- **Udhëzuesit lidhur me kriteret për aplikantët e granteve, % e grantit nga MZHR dhe bashkëfinancimit janë të sqaruara te pika 1.5. për - P.sh:**

### **PZHRB 2021**

*LOT 1 (startup) dhe LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit, ose maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit.*

### **PRE M15 2021**

*- LOT 2, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit ose maksimumi i bashkëfinancimit 6,666.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 10,000.00 (60%) = 16,666.00 vlera totale e projektit .*

*- Loti 3 - minimumi i bashkëfinancimit 1,111.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 10,001.00 (90%) = 11,112.00 vlera totale e projektit ose maksimumi i bashkëfinancimit 9,999.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (60%) = 24,999.00 vlera totale e projektit.*

64. Ne jemi biznes eksiztues nga 2011. Në cilin lot duhet të vazhdojmë ta plotësojmë aplikacionin përmes eKosova? ( të bashkangjitura i gjeni lotet si foto të marra nga eKosova).

- Viti i regjistrimit të biznesit nuk e përcakton Lot-in. Biznesi duhet të jetë i regjistruar para 1 janarit 2021.

65. Mirëdita, jam ??? ??? nga Suhareka pronar i një biznesi individual. Si mundem me u informu rreth mënyres së aplikimit për grant nga MZHR?

- Vizito webfaqen e MZHR-së linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>.

66. A ka ndonjë manual në web faqen e MZHR-së rreth afateve kohore, cilët janë sektorët me prioritet dhe mënyres së aplikimit ? Nëse ka, ju lutem më dërgoni linkun adekuat!

- Në web faqen e MZHR me kohë janë bërë njoftimet, janë publikuar Udhëzuesit, Orari indikativ etj. Vizito webfaqen e MZHR-së linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>.

67. Në pjesën e aktiviteteve dhe organi implementues nuk e kam të qartë. Ju lutem a mund të më ndihmoni, të sqaroni ose të dërgoni një shembull? Bëhet fjalë për pjesën si në foton.

V. PLANI I VEPRIMIT

Fshije aplikimin

Aktiviteti	MUAJI 1	MUAJI 2	MUAJI 3	MUAJI 4	MUAJI 5	MUAJI 6	Organi implementues
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...
Plotëso...	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Plotëso...

Fshij resht + Shtoi resht



- **Varet kush është organi implementues sipas projekt propozimit tuaj.**

68. Desha informata rreth aplikimit për grant për hapjen e një biznesi të ri për femra në leminë e prodhimit të zogjëve me inkubator. Si të aplikoj apo si të veproj që të marrë një përkrahje financiare për fillimin e këtij biznesi?

- **Në web faqen e MZHR gjeni Udhëzuesit, Orarin indikativ etj. Vizito web faqen e MZHR-së në linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>.**

69. Gjatë plotësimit të formularit kemi nevojë për sqarim si në vazhdim: Gjatë hapjes së llogarisë ishte një buton "Klikoni këtu për të ngarkuar autorizimin për organizatën tuaj". Unë jam vet pronari i kompanisë që po aplikoj, a kam nevojë për të bërë ndonjë autorizim për të aplikuar ?

- **Ngarko certifikaten e biznesit sikur në folderin paraprak.**

70. Gjatë mbushjes së aplikacionit në pikën V. Plani i veprimit, çka duhet të plotësohet tek fusha "Organi implementues"?

- **Evidento Organin Implementues p.sh. në rastet kur aktiviteti është i juaji, e shënon emrin e biznesit apo furnizuesit të paraparë me pajisje apo shërbime.**

71. Makinerinë që planifikojmë ta blejmë përmes këtij granti do të importohet nga Turqia. A duhet të llogariten tatimet që aplikohen në Kosovë apo vetëm vlera e pajisjes sa kushton në fabrikë?

- **Vetëm vlera e makinerisë sipas profaturës. Transporti, dogana dhe shpenzimet e tjera eventuale nuk janë kosto të kualifikueshme.**

72. Jam një bujk nga Gjakova. Kam nevojë shume për një makinë për dujë të sanës.

- **Bujqësia është sektor që nuk kualifikohet. Shih Udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve, konkretisht pikën 2.4.**

73. Përshëndetje i nderuar, desha të ju parashtroj një pyetje në lidhje me grantet nga MZHR. Nëse firma plotëson kushtet për aplikim për Lot 3, a mundet që të aplikon për blerje të pajisjes/pajisjeve që kushtojnë më shtrenjtë se vlera e grantit ( psh një pajisje kushton 50,000€, aplikuesi kërkon nga MZHR të financojë me 15,000€ ndërsa 35,000€ do të financojë aplikuesi)? A vlenë kjo edhe për Lot 2 ?

- **Shuma e bashkëfinancimit në asnjë rast nuk guxon të tejkalojë shumën prej 40% të vlerës së përgjithshme të Projekt Propozimit.**

74. E pashë në një faqe që është hapë thirrja për grante për biznese start up. Desha të informohem ku mundem të aplikoj nëse ka mundësi ta di apo duhet të vijë fizikisht t'i marrë aplikacionet? Ju falemderit e punë të mbarë! Me respekt ??? ???.

- Në web faqen e MZHR gjeni Udhëzuesit, Orarin indikativ etj. Vizito web faqen e MZHR-së në linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22> .

75. Kam bërë regjistrimin deri në fund, por më thotë prit kodin telefonik por nuk më vjen kodi në telefon. Si të aplikoj kur nuk më jipet mundësia?

- Ju mund të kërkonte sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net) .

76. A kam të drejtë si Restaurant të aplikoj për tavolina dhe karrige ose për ndërtimin e terasës me e rritë kapacitetin e punës?

- **Gastronomia është sektor i kualifikueshëm por inventari dhe aktiviteti për të cilin ju bëni pyetje hyjnë në shpenzime të pakualifikueshme - lexo Udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve konkretisht pikën 2.7.**

77. Çdo grant i kërkuar sipas kësaj Thirrjeje për Propozime duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale: Loti 2 - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla Nga 5,000.00 € deri në 10,000.00 €;

A mund të aplikoj për pajisje në vlerën 11,000.00 ku brenda kësaj shume është edhe bashkëfinacimi mbi 10%?

- **PO.**

78. Nëse një pajisje kushton p.sh. 3000 dollarë, d.m.th oferta është me valutë (dollarë). Ofertuesi pagesën e pranon vetëm në dollarë. A duhet të konvertohet në euro apo duhet të merret në dollarë? Nëse duhet të konvertohet, si duhet bërë një veprim i tillë?

- **Ofertat në valuta të tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar.**

79. Ofertat në valuta tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar. Si duhet të llogaritet kjo gjë?

- **Ofertat në valuta të tjera duhet të bashkangjesin kursin me të cilin është kalkuluar.**

80. Pasiqë linku në faqe nuk po funksionon, a ka mundësi të na dërgoni formularin e aplikimit për grante për Lot 1 biznes ekzistues? Faleminderit!

- Aplikacionet plotësohen vetë online, linku është duke funksionuar pa probleme: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22> .

81. Gjatë procesit të plotësimit të të dhënave në eKosova e kam dhënë gabim numrin e telefonit dhe nuk po më vjen kodi. Si mund ta rregulloj këtë problem?

- Ju mund të kërkonti sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net)

82. Po iu shkruaj lidhur me një sqarim rreth Skemës së Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 (Lot II dhe Lot III).

Ne jemi autoshkollë dhe nëse duam të bëjmë aplikimin për mbulim të kostos së blerjes së një automjeti, i cili për veprimtarinë tonë është mjet pune (investim në asete të prekshme) a mund të kualifikohemi për fitim të grantit, meqë me këtë veprim do të vinte jo vetëm deri tek mbajtja e punëtorëve aktual mirëpo edhe deri tek punësimi i punëtorëve të rinjë (shofer-instruktorëve), apo do të mund të diskualifikoheshim që në start?

Arsyeja pse po pyes është sepse tek kostot e pakualifikueshme janë futur automjetet e transportit.

Siç e ceka edhe më lart, automjetet për veprimtarinë tonë janë mjete pune esenciale (asete të prekshme).

Aplikimin synojmë ta bëjmë për LOT3 si ndermarrje e vogël meqë kemi të punësuar mbi 10 punëtorë.

- **Ashtu siç e keni vërejtur edhe ju tek Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve mjetet e transportit llogariten si kosto e pakualifikueshme.**

83. Kam një pyetje lidhur me Grantet të cilat janë shpallur nga MZHR, më saktësisht pika 2.4 Sektorët apo Temat: Kompanitë e sektorit të IT-së të cilat deshirojnë të zhvillojnë produkt softuerik i cili do ofrojë zgjidhje vendore dhe ndërkombëtare, a mundën me apliku në këtë grant?

- **Spektori i shërbimeve të TI është spektori i kualifikueshëm.**

84. Jam ??? ???, kam 2 biznese të regjistruara në emrin tim, njëri Biznes Individual dhe tjetri Sh.P.K. dhe të dy janë me aktivitete të Programimit Kompjuterik. Desha të informohem rreth Granteve për Biznese që po jep Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Të ardhurat e tatimit në fitim në ATK i kam të deklaruara me Zero (0). A kam të drejtë të aplikoj për ndonjë Grant në MZHR si biznese Start Up ose për rimëkëmbjen ekonomike të Grave në Biznes ose në Teknologji ose nëse ka ndonjë program tjetër për Mbeshtetjen e Bizneseve?

- Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve kanë paraparë që bizneset ekzistuese për të fituar të drejten e aplikimit, minimumin e qarkullimit vjetor për vitin 2020 ta kenë në shumën 500€. Kurse sa i përket pjesës së fundit të pyetjes tuaj, secili shtetas i Republikës së Kosovës që nuk ka biznes të regjistruar në emrin e tij/saj ka të drejtë të aplikoj në kategorinë Start-up.

85. Ju lutem më informoni se a kam të drejtë aplikimi në Grantin që është hapur nga MZHR nëse qarkullimi vjetor kalon 500.000 Euro?

- Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve kanë paraparë që bizneset ekzistuese për të fituar të drejten e aplikimit, qarkullimin maksimal vjetor për vitin 2020 duhet ta kenë deri në shumën 500,000.00€. Shih udhëzuesin për aplikantë, pika 1.4.

86. A përkrahet importi i makinerisë prej jashtë shtetit të Kosovës, sepse për idenë StartUp që do të aplikoj, nuk po mund të gjej oferta për makineri në Kosovë?

- Vendin e blerjes së makinerisë e përcakton aplikuesi përmes ofertës të cilën e bashkangjet si dokument.

87. A përkrahet idea në fushën e IT, p.sh. hapja e webfaqeve, d.m.th ide biznesi online?

- Sektori i shërbimeve të TI është sektor i kualifikueshëm, kurse sa i përket uebfaqes lexo Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve, pikën 2.6 konkretisht në pikën aktivitetet e marketingut.

88. Jemi duke dashur që të aplikojmë në grante por nuk po hapet linku i cekur. A ekziston ndonjë link tjetër për plotësim online?

- Linku është funksional: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22> .

89. Përshëndetje, desha të pyes rreth granteve për start up. A mundeni me e sqaru më në detaje dhe ta jepni një shembull se si duhet plotësuar formulari te pjesa PLANI I VEPRIMIT dhe te pjesa PROJEKSIONI FINANCIAR (Nëse mundeni me tregu një shembull të një biznesi)?

- Plani i veprimit paraqet aktivitetet që do të realizohen gjatë zbatimit të projektit. Projektioni financiar paraqet një parashikim financiar të biznesit për vitet e përcaktuara në formular të aplikimit.

90. Shtojca C1 - Deklarata e aplikantit, si duhet të plotësohet te pjesa ku shkruan "nënshkrimi" dhe a duhet të ngarkohet në formatin që është apo në formatin PDF?

- **Dokumentet duhet të jenë me dukshmëri të qartë dhe të formatit PDF. Secili dokument duhet të vendoset në folderin përkatës**

91. Ju lutem na informoni apo na dërgoni linkun se ku mundem me i pa kushtet apo lajmërimin për aplikim në grante në webfaqen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal ku janë mënyra se si aplikohet apo dokumentacioni që kërkohe?

- <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>

92. Oferta për pajisje dhe makineri për të cilat kërkohet financim, a duhet të merret vetëm për pajisjet për të cilat kërkohet financim nga Ministria e Zhvillimit Rajonal apo për të gjitha pajisjet që janë të nevojshme edhe ato që merren me vetëfinancim?

- **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt merret për vlerën totale të projektit apo në oferta të ndara por që mbulojnë shumën totale të projektit.**

93. 10% e vlerës së kërkuar për financim nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, apo e gjithë projektit?

- **Përqindja e bashkëfinancimit kalkulohet nga vlera totale e Projekt Propozimit.**

94. Jam ??? ???? dhe desha të marrë një informacion nga ju. Kompania ime është kompani shumë e re, Start-up dhe është regjistruar në muajin Tetor të vitit 2020. Aktivitet e saj janë në fushën e automatizimit Industrial dhe prodhimit të makinave. Por, deri më tani kompania nuk ka bërë asnjë qarkullim financiar, është ende në fazat e para. Pyetja është: a kam të drejtë të aplikoj në Lotin 1, pra për Start-up apo jo?

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up.**

95. Jam ??? ???? dhe jam duke punuar për të aplikuar në thirrjen e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal - Skema e Grantëve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2021 përkatësisht për Lot 1 Start-up.

Pyetja ime është se tek pika ku kërkohet të dëshmohet Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit, a duhet të dëshmohet vetëm oferta e makinerisë apo duhet të dëshmojmë me ofertë për çdo shpenzim që kam shkruar në formular (p.sh. stoku fillestar, marketingu, shpenzimet e interierit etj.)?

- **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt duhet të jetë për vlerën totale të projektit, sikur që duhet të ketë përputhje të plotë me buxhetin e propozuar në vlerë dhe përshkrim**

96. Shpresoj që të mos ju shqetësoj. Kam hapur llogarinë në eKosova dhe kam filluar të plotësoj të dhënat në Lot 2, mirëpo duke e testuar sistemin dhe të shoh cilat dokumente kërkohen për t'u ngarkuar, kam shtypur butonin që e kam përfunduar aplikimin. Në të vertetë aplikimi nuk është i plotë dhe dua që të më jepet mundësia të rihap përsëri. Kam bërë pyetje sot në trajnimin që u mbajt nga MZHR dhe më thanë që të bëjë kërkesë për rihapje në eKosova. Kërkesën tashmë e kam bërë.

- **Ju mund të kërkontë sqarime ose rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net).**

97. Te LOT 1 **Startup biznes** nëse një pajisje blihet jashtë vendit p.sh. prej Kinës atëherë dërguesi porosinë e dërgon deri në Durrës, Shqipëri. Si duhet të veprohet me pagesën për transport prej Shqipërisë në Kosovë si dhe pagesën për doganë?

- **Shpenzimet për doganë dhe transport janë kosto të pakualifikueshme.**

98. Unë sapo përfundova aplikimin për lot 1 mirëpo Shtojcën C1 nuk e kam nënshkruar, vetëm e kam shkruar emrin dhe mbiemrin, nuk e kam kuptuar që duhet me e nënshkruar dhe pastaj me e skanuar si PDF?

- **Ju mund të kërkontë rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net) dhe ta kompletëni aplikacionin tuaj ashtu siç përshkruhet në Udhëzues.**

99. Nëse një kompani private ka qarkullim mbi 500.000 euro gjat vitit 2020 dhe ka pasur 184 punëtorë gjat vitit 2020, a lejohet aplikimi për Lot 3, ju lutem më ktheni përgjigje?

- **Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve pika 1.4 dhe 1.5 kanë paraparë që bizneset ekzistuese për të fituar të drejtën e aplikimit qarkullimin maksimal vjetor për vitin 2020 duhet ta kenë në shumën deri në 500,000.00 €. Sikur që të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet mikro dhe të vogla por jo edhe ndërmarrjet e mesme ku kategorizohet ndërmarrja e juaj bazuar në numrin e punëtorëve.**

100. Në procesin e regjistrimit si biznes në platformën online eKosova, në pjesën ku kërkohet të ngarkohen dokumentet e nevojshme, një nga këto dokumente që kërkohet është edhe autorizimi. Për çfarë lloj të autorizimit bëhet fjalë? Nëse unë jam pronar i firmës me të cilën regjistrohem a më duhet ky autorizim? A ka ndonjë format të

posaçem të autorizimit? Nëse mundeni me na ofru informata më të hollësishme në këtë pikë?

- **Nëse jeni pronari ju mund t'i fusni të dhënat sikur tek rasti i pronarit ose vetëm faqen 5 të certifikates së biznesit.**

101. Në procesin e regjistrimit si biznes në platformën online eKosova, në pjesën ku kërkohet të ngarkohen dokumentet e nevojshme, një nga këto dokumente që kërkohet është edhe autorizimi. Për çfarë lloj të autorizimit behet fjale? Nëse unë jam pronar i firmës me te cilën regjistrohem a me duhet ky autorizim? A ka ndonjë format të posaçem të autorizimit? Nëse mundeni me na ofro informata me te hollësishme në këtë pike.

- **Nëse jeni pronari ju mund ti fusni të dhënat sikur tek rasti i pronarit ose vetëm faqen 5 të certifikates së biznesit**

102. Nëse Kompania duhet të konkurroj për Lot 3 - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla, a duhet që shuma e pro faturës të jetë ndërmjet shumave Nga 10,001.00 € deri në 15,000.00 € apo pro fatura mundet të jetë edhe më e madhe me kusht që 60% i Grantit nga MZHE të mos ta tejkalojë shumën 15,000.00.

- **Vlera e profaturës mund të jetë mbi 15,000.00€ me kusht që granti i kërkuar nga MZHR për Lot 3 të mos e tejkaloj këtë shumë, sikur që edhe shuma e përgjithshme e bashkëfinancimit duhet të jetë sipas kriterëve të udhëzuesit pra prej 10%-40%**

103. Jemi biznes restaurant që shërbejmë ushqime në restaurant dhe me porosi. Deshta të ju pyes nëse ne si restaurante mund të aplikojmë për grante në masën 15 për blerje të pajisjeve të reja furra, frigorifer apo të ngjashme.

- **Gastronomia është sektor i kualifikueshëm sikur edhe aparatutë që je e keni specifikë.**

104. Deshta të ju pyes se sa është maksimumi i qarkullimit që duhet ta ketë biznesi për lotin 2 a është 500 mijë për 2020.

- **Për Lot 2 qarkullimi maksimal për vitin 2020 bazuar në pikën 1.4 të Udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve është 15,000.00€**

105. Ne jemi biznes ekzistues që i përkasim Grantit të Lot 3, ndërsa aktivitet kryesor (Kodi 4752) i biznesit është tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara. Kurse si aktivitet dytësor (Kodi 4321) kemi instalimet elektrike, (që do të thotë se biznesi ynë merret me këto aktivitete edhe shitje, edhe shërbime). Pyetje ime është: A kemi të drejtë aplikimi në këtë grant, nëse jo PSE?

- Bazuar në pyetjen tuaj dhe duke u mbështetur në Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve ju nuk mund të aplikoni në emër të aktivitetit kryesor që mbani në Certifikatën e biznesit por ju mund të aplikoni me aktivitetin sekondar gjithnjë duke ju përmbajtur me përpikëri Udhëzuesit dhe kriterëve për aplikantët e granteve.

106. Dua te informohem lidhur me Skemën e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2021 (Lot 1 Start-up dhe Lot 1 biznes ekzistues) Unë e kam regjistruar biznesin ne muajin 10/2020, por nuk kam pas asnjë qarkullim akoma, kam deklaruar me zero, pyetja është:

A duhet te aplikoj për Lot 1 Start-up apo Lot 1 Biznes ekzistues?

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up, kurse për të aplikuar në Lot 1 biznes ekzistues qarkullimi për vitin 2020 duhet të jet s’paku 500€.**

107. Jam duke u munduar të hapi një llogari për kompaninë në eKosova, mirëpo te dokumentet e nevojshme me kërkon edhe autorizimin e organizatës, nuk po e kuptoj për çfarë dokumenti bëhet fjalë, a mund të me jepni një sqarim të lutem?

- **Nëse jeni pronari ju mund ti fusni të dhënat sikur tek rasti i pronarit ose vetëm faqen 5 të çertifikatës së biznesit**

108. Jam ??? ??? dhe jam e interesuar të aplikoj në skemën e granteve, "Programi i Zhvillimit Rajonal te Balancuar" PZHRB 2021 (Lot 1 Start-up dhe Lot 1 biznes ekzistues). Unë sapo e kam regjistruar biznesin e rrobaqepësisë dhe doja te ju pyes ne cilën nga kategoritë kam të drejte të aplikoj për grante ( Lot 1 Start-up apo Lot 1 biznes ekzistues).

Do ju isha mirënjohëse nëse më dërgoni edhe listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim.

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up, kurse për të aplikuar në Lot 1 biznes ekzistues qarkullimi për vitin 2020 duhet të jet s’paku 500€.**

109. Në disa raste Operoret Ekonomik, në vend të Ofertës e shënjon Profaturë, a është e pranuar si e mirëqene kjo nga MZHR

- **Në këtë fazë po!**



110. Nëse mundeni të më ndihmoni nuk po mundem të qasem fare ne këtë <https://ekosovacms.rks-gov.net/> për aplikim për grante,

- **I nderuar provo, linkun në vijim: <https://ekosova.rks-gov.net/> edhe tek thirrja për propozime në webfaqe të ministrisë kur ta hapni thirrjen për propozime klikoni mbi ekosova dhe automatikisht ju hapet menyuja për regjistrim.**

111. Në thirrjen e ministrisë po shkruan qe Start-up nuk duhet të jete i regjistruar. Kemi një rast ku e kanë themeluar biznesin para një muaj ndërsa nuk është funksionalizuar ende vetëm është hapur si biznes, A kane mundësi me apliku .Apo nuk duhet te jete e hapur si biznes fare.

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up**

112. Desha të ju bej një pyje në lidhje me shpalljen e thirrjes së Skemës së Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 (Lot II dhe Lot III). Me qenë se kompania ime ka të punësuar dhe rangohet në listën e kompanive që ka të punësuar 0 – 9 punëtor, por qarkullimi vjetor është mbi 15,000 €, siç është paraparë me Udhëzuesin për Aplikim. Prandaj a mund të më tregoni se në cilin Lot kompania ime mund të aplikoj ne këtë thirrje?

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 por edhe nr. i punëtorëve të jetë brenda kritereve për ndërmarrjet Mikro dhe të vogla, në rastin konkret Ndërmarrja me nr. prej 0-9 punëtorë ka të drejtë të aplikoj në Lot 3.**

113. Po ju shkruaj në lidhje me Thirrjen për Propozime “Skema e Granteve „Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021“ Masa 15 (Lot II dhe Lot III)” e shpallur nga Ministria e Zhvillimit Rajonal. A mund të aplikojë për rritjen e fermës së pulave bio ku produkt kryesor kam shitjen e vezëve bio në tregun kosovar dhe rajonal?

- **Bujqësia është sektor që nuk kualifikohet.**

114. Si kalkullohet përqindja e bashkë investimit? Nëse aplikojë për 15 mijë euro dhe dua të bashkë investojë 10% i bie që unë të bashkëinvestojë 1650 euro dhe në total projekti kalon në 16,650 euro. Apo projekti nuk guxon të kalojë 15 mijë euro në total se bashku bashkë me bashkëinvestim prej 10% dhe nuk guxon të kalojë 15 mijë euro?

- **Shuma e kërkuar nga MZHR nuk guxon të tejkaloj shumën prej 15,000.00 € për Lot 3, kurse shuma totale e buxhetit në Projekt Propozim mund të shkoj deri në 40% bashkëfinancim.**

## **PZHRB 2021**

*LOT 1 (startup) dhe LOT 1, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit, ose maksimumi i bashkëfinancimit 3,333.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (60%) = 8,333.00 vlera totale e projektit.*

## **PRE M15 2021**

*- LOT 2, (Biznes ekzistues) - minimumi i bashkëfinancimit 555.50 (10%) + kontributi i MZHR-së 5,000.00 (90%) = 5,555.50 vlera totale e projektit ose maksimumi i bashkëfinancimit 6,666.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 10,000.00 (60%) = 16,666.00 vlera totale e projektit .*

*- Loti 3 - minimumi i bashkëfinancimit 1,111.00 (10%) + kontributi i MZHR-së 10,001.00 (90%) = 11,112.00 vlera totale e projektit ose maksimumi i bashkëfinancimit 9,999.00 (40%) + kontributi i MZHR-së 15,000.00 (60%) = 24,999.00 vlera totale e projektit.*

115. Jam e interesuar të aplikoj për një grant për Start -up dhe deshta të pyes sepse këtu linqet për të aplikuar në udhëzuesin nuk hapen.

- **Shfrytëzo linkun në vijim dhe Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>**

116. Unë jetoj në një Komunë tjetër, kurse biznesin e kam të regjistruar dhe veproj në një komunë tjetër. Ajo që më intereson ka të bëjë se a do të referoheni gjatë vlerësimit adresës së banimit të pronarit apo adresës së biznesit, në mënyrë që ta dije se cilit regjion do ti takoj?

- **Referoju Rajonit Zhvillimor ku zhvillon aktivitetin Biznesi.**

117. Meqë pasi të parakualifikohemi na kërkohet përsëri vërtetimi i ATK-se që nuk kemi obligime dhe me të cilin dëshmohet shuma e qarkullimit për vitin 2020, është e pa qarte për mua se kush duhet ta marr në ATK vërtetimin me qarkullim, ju si Ministri keni ndonjë mundësi me kërkua direkt apo duhet Ne me nxjerr ( e shqetësimi ynë është që sistemi Edi nuk po na lejoj ka me nxjerr Vërtetim me qarkullim të evidentuar sepse unë menjëherë tentova me nxjerr tani gjatë aplikimit, por s'pata mundësi me intervenua në vërtetim dhe me shënue shumën e qarkullimit)

- **Vërtetimi tatimor në ATK merret nga pronari i biznesit ose i autorizuari i ti.**

118. Bisnesi është fillestar i sapa regjistruar , në cilin Lot të aplikojmë në START UP LOT 1 pasi ne kemi biznes i regjistruar ne 2021.

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up, kurse për të aplikuar në Lot 1 biznes egzistues qarkullimi për vitin 2020 duhet të jet s'paku 500 €.**

119. Unë jam ??? ???? , u regjistrova të platforma Ekosova, po kërkoja ndonjë formularë që kërkon me shume të dhëna por spo e gjej, përveç asaj me deklaratën e aplikantit.

- **Në web faqen e MZHR janë të publikuara bashkë me thirrjen edhe udhëzuesit dhe dokumantacioni i nevojshëm përcjellës. Shih linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>**

120. Kemi nevojë për informacione shtesë: Jemi biznes prodhues njëherit jemi edhe exportues të kuzhinave, pasi kemi nevojë për makineri më të avancuar , dhe na duhen ofertat me i marrë jemi të interesuar shumen e grandit për me pas një orientim mbi kërkesën që do ta bëjmë. Jemi biznes i ri por kemi pasur një qarkullim exportues mbi 160000 €

- **Bazuar në të dhënat që ofroni lidhur me qarkullimin e biznesit tuaj, qarkullim ky nëse është për vitin 2020 ju mund të aplikoni në kategorinë Lot 3, gjithnjë nëse i plotësoni edhe kriteret tjera të përshkruara në Udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve.**

121. Kemi një kërkesë për sqarim rreth ndarjes së madhësisë së ndërmarrjes me numër të punëtorëve dhe qarkullim vjetor.

*Te Udhëzuesi shkruan kështu: Granti do të ndahet në dy Lot, si vijon:*

- Loti 2 – **Ndërmarrjet mikro dhe të vogla** (Të regjistruara para datës 01.01.2021) si dhe duhet të kenë qarkullim minimumi **7,001.00€ deri në 15,000.00 €** të dëshmuara/deklaruara në ATK për vitin e fundit fiskal (2020).

- Loti 3 – **Ndërmarrjet mikro dhe të vogla** (Të regjistruara para datës 01.01.2021) si dhe duhet të kenë qarkullim mbi **15,001.00 deri në 500,000.00€** të dëshmuara/deklaruara në ATK për vitin e fundit fiskal (2020).

Sqarim: Ndërmarrjet mikro dhe te vogla kategorizohen si në vijim:

1. Ndërmarrjet **mikro prej 0-9 punëtor;**
2. Ndërmarrjet **e vogla prej 10-49 punëtor.**

- Ne e kemi një rast specifik, Ndërmarrja ka **6 punëtorë**, por ka të hyra afër **500,000.00 Euro.**

A mund të aplikojmë për Lot 3? [D.m.th.](#) si ndërmarrje **MIKRO me 6 punëtorë** por me të hyra rreth **500,000.00.**

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 si dhe nr. i punëtorëve të jetë brenda kriterve për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, në rastin konkret**

**Ndërmarrja me nr. prej 6 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 3 me kusht që qarkullimi nuk e tejkalon shumën prej 500,000.00€**

122. Nëse kompania ka 3 punëtor të punësuar dhe ka qarkullim prej 180.000,00 Euro, A duhet të aplikoj për "Lot 3 biznes ekzistues"?

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 si dhe nr. i punëtorëve të jetë brenda kriterëve për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, në rastin konkret Ndërmarrja me nr. prej 3 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 3 biznes ekzistues.**

123. Unë jam ??? ???? nga kompania ??? ???? Group SHPK me lokacion në Prishtinë. Rreth këtij grantit të shpallur : **"Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar" PZHRB 2021"**

Në file-in e publikuar për kompanitë ekzistuese LOT 1 Bizneset ekzistuese, a duhet të jete maksimumi i qarkullimit të biznesit 7000 euro për vitin 2020, apo ska problem të jetë edhe me vlerë më të madhe për të u kualifikuar në këtë projekt?

- **Për aplikim në kategorinë Lot 1 qarkullimi maksimal për vitin 2020 duhet të jetë 7,000.00€**

124. A mundeni të ma dërgoni një listë të dokumenteve që janë të nevojshme të i bashkëngjesisim në grantin e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal \*(Masa 15)

- **Në web faqen e MZHR janë të publikuara bashkë me thirrjen edhe udhëzuesit dhe dokumentacioni i nevojshëm përcjellës. Shih linkun në vijim: <https://mzhr.rks-gov.net/page.aspx?id=1,22>**

125. A kualifikohen bizneset që veprimtarinë e kanë hotelieri? Nëse po , atëherë a mund të aplikohet për blerjen e aparateve të ndryshme lidhur me funksionimin e lokalit ( aparat kafeje ,furre e picave etj) ? - Inventari : ( karriga tavolina) etj.....

- **Gastronomia është sektor i kualifikueshëm, aparatura e cekur nga ju hynë në shpenzime të kualifikueshme kurse inventari në shpenzime të pakualifikueshme, për më shumë lexo piken 2.7 kualifikueshmëria e shpenzimeve të udhëzuesit dhe kriteret për aplikantët e granteve.**

126. Jam i interesuar për start up në grantet e reja që ofron Ministria. Kam një pyetje rreth start up biznesit. A duhet që të hapet biznesi pastaj të aplikohet apo si duhet vepruar? Sepse tek dokumentet shtese shënon që duhet të kemi disa dokumente ku nder to është edhe regjistrimi i biznesit.

- **Për Start-up fillimisht aplikohet e nëse kualifikoheni atëherë bëhet regjistrimi i biznesit.**

127. Dashta t'ju bejë një pyetje lidhur me "Skema e Granteve,,Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" Masa 15(Lot II dhe Lot III). Firma jone numëron 8 punëtore, por qarkullimi vjetor është mbi 140,000.00 Euro, ne me punëtor kategorizohemi si ndërmarrje mikro, por me qarkullim kategorizohemi si ndërmarrje e vogël, në cilën shume duhet te aplikojmë: Lot 2 - Nga 5,000.00 € deri në 10,000.00 €; apo Lot 3 - Nga 10,001.00€ deri në 15,000.00€; ?

- **Përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 si dhe nr. i punëtorëve të jetë brenda kriterëve për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, në rastin konkret Ndërmarrja me nr. prej 8 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 3**

128. Sipas udhëzuesit Vlera e Grantit eshte 2,000€ deri 5,000€ , ( që do të thotë vlera e Projektit mundet te jete deri ne 5,000€ / 60%= 8333€ vlera e grantit apo 5,000€ është vlera e projektit përfshire edhe bashkëfinancimin) , ju lutem për sqarimin tuaj

- Nëse aplikanti me buxhetin e Projekt Propozimit kërkon shumën prej 5,000.00€ si grant nga MZHR, aplikanti ka mundësi të bashkëfinancoj Projekt Propozimin deri 40%.


129. Biznesi ynë është themeluar ne Gusht të vitit 2020, dhe deri në dhjetor 2020 nuk kemi arritur qarkullimin 500 euro minimum. A kemi të drejte të aplikojmë në Lot-in 1 start-up apo në Lotin 1 ekzistues, apo nuk kemi mundësi te aplikojmë fare në skemën e granteve?

- **Biznesi i juaj ashtu siç ju deklaroni është i regjistruar në ARBK, rrjedhimisht nuk i takon kategorisë Start-up, kurse për të aplikuar në Lot 1 biznes ekzistues qarkullimi për vitin 2020 duhet të jet s'paku 500€.**

130. Për të aplikuar në grant desha me ju pyet a lejohet që të aplikohet për kopshte për fëmijë ku jemi të gatshëm për bashkfinancim 50% si dhe a duhet me qen biznesi i hapur apo te start up, tolerohet që të aplikojnë ata që kanë ide për biznes dhe pasi të fitohet grant mundet me hap biznesin. Ju falemnderit dhe presim përgjigje nga ana e juaj.

- **Veprimaria e Kopshteve është sektor i kualifikueshëm, bashkëfinancimi nuk mund të kaloj shumën prej 40%, për start-up biznesi nuk ka nevojë të jet i regjistruar.**

131. Nuk po mund të qasem në sistemin tuaj, kam kaluar me siguri disa hapa, edhe kam këtë problem siq po u'a bashkangjes:



Ju lutem a mund të kem qasje në sistem.

- **Ju mund të kërkonte rihapje të sistemit përmes një kërkesë drejtuar në emailin: [ekosova@rks-gov.net](mailto:ekosova@rks-gov.net) dhe ta kompletoni aplikacionin tuaj ashtu siç përshkruhet në Udhëzues.**

132. Duam të aplikojmë në grantet e ministrisë përkatëse por qasja së pari në Ekosova është e pamundur pasi që ne jemi me Lejeqendrim dhe numrin personal e kemi me 29..... dhe sistemi nuk na lejon qasjen. Ju Lutem a mund të paraqitni këtë problem në Stafin e IT-se nëse ushtrojmë biznes në Kosovë por jemi me Lejeqendrim!

- **Bazuar në udhëzuesin dhe kriteret për aplikantët e granteve aplikanti duhet të jet shtetas i Republikës së Kosovës, lexo piken 2.1 të Udhëzuesit.**

133. Ju paraqitemi nga kompania LOOPUS me seli në Prishtinë, do të doja të ju pyes me mirësi se kur do të mbahet sesioni i siperpermendur? Dikund është theksuar me datë 10 Mars, por fillimisht doja të sigurohesha zyrtarisht nga ju.

- **Sesioni informues është mbajtur më 10.03.2021, në dy sesione ashtu siç kishim bërë edhe njoftimin paraprakisht.**

134. A mund të me jepni më shumë sqarime te pika 4.Kriteret e Vlerësimit. Konkretisht qka nënkupton secila nga 5 Elementet e notimit:

Kapaciteti financiar dhe operacional

Relevanca e veprimit

Efektshmëria dhe arritshmëria

Qëndrueshmëria e veprimit

## Buxheti dhe efektshmëria në kosto

Ne jemi duke shiqur mundësinë për të aplikuar në Skemën e Granteve të Programit për rimëkëmbje ekonomike 2021 Masa 15.

Në këtë kontekst, do t'ju jemi shumë mirënjohës nëse do t'na shkaroni në formë më të detalizuar Elementet e Notimit në Kriteret e vlerësimit, dhe këto me sa vijon:

Kapaciteti financiar dhe operacional

Relevanca e veprimit

Efektshmëria dhe arritshmëria

Qëndrueshmëria e veprimit

Buxheti dhe efektshmëria në kosto

- **Secila nga pesë kategoritë e vlerësimit është e ndërlidhur me pyetjet në aplikacion, planin e veprimit dhe buxhetin e prezantuar nga aplikuesi.**

134. Jam ????, Drejtoreshë e IT Center në Leposaviq. Jam e interesuar për grant por kam problem me regjistrim në portalin ekosova dhe gjatë procesit të regjistrimit më kërkohet të bashkangjes autorizimin.

- **Nëse jeni pronare e biznesit, mund ta bashkangjitni faqen e certifikatës së biznesit ku dëshmohet se jeni pronare, nëse jo duhet të bashkangjitni Autorizimin nga Pronari.**

Unique Numeric Identifier (NUI):

Click here to upload a front photo of your ID

Click here to upload a back photo of your ID

Click here to upload a photo of you and your ID together

Click here to upload your organization's business certificate

Click here to upload your organization's authorization document

Cancel Continue



Kliknite ovde da biste otpremili ovlašćenje  
svoje organizacije



Klikoni këtu për të ngarkuar autorizimin  
për organizatën tuaj

136. Nëse biznesi egzistues nuk ka qarkullim( per shkak të pandemi ) ne 2020 a i lejohej te aplikoj per lot 1 ?

- **Jo**

137. Kriteret e Vleresimit janë shumë të përgjithësuara dhe potencialisht len vend për interpretim subjektiv. Ju lutemi që për secilin pozicion të jepni disa shembuj të matshëm.

- **Secila nga pesë kategoritë e vlerësimit është e ndërlidhur me pyetjet në aplikacion, planin e veprimit dhe buxhetin e prezantuar nga aplikuesi.**

138. Cili autorizim i biznesit kërkohet gjatë regjistrimit (foto)?

- **Autorizimi nga kompania juaj, autorizim nga noteri apo autorizim në formë tjetër**

139. Ku duhet te ngarkohet foto me letërnjoftim në dorë (selfie) dhe kopja e certifikatës?

- **Gjatë marrjes së qasjes**



140. Nëse mund të kemi një sqarim me të detajuar për numrin e punëmarrësve që një kompani duhet të ketë për të gjitha llojet e lloteve

- **Sqarim lidhur me numrin e të punësuarve sipas ndërmarrjeve:**  
Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtor;  
Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtor, mirëpo përcaktues për Lot është qarkullimi për vitin 2020 e jo nr. i punëtorëve të ndërmarrjeve Mikro dhe të vogla, në rastin konkret Ndërmarrja me nr. prej 4 punëtorëve ka të drejtë të aplikoj në Lot 3

141. Nëse një biznes ka qarkullim mbi 800.000 euro gjatë vitit 2020 a ka të drejtë të konkuroj ne Lot 3

- **Jo, shih pikën 1.4. të Udhëzuesit për Aplikantët**

142. Në qfarë formati duhet me i ngarku dokumentet e nevojshme

- **Dokumentet e nevojshme duhet të ngarkohen në formatin PDF**

143. Nuk jemi deklarues i TVSH. A është TVSH kosto e pranueshme dhe a duhet që si kosto ti shtohet koston së paisjës e cila vjen nga Importi.

- **TVSH është kosto e pranueshme.**

144. Platforma "ekosova" nuk po hapet ne ëeb?

- **Hapet në linkun: [ekosova.rks-gov.net](http://ekosova.rks-gov.net)**

145. Përshendetje! A pranohet oferta ne valutë të huaj, p.sh. \$, ngase ka makineri që duhet të importohen që duhet doemos të paguhen me \$, sepse furnitorët nuk pranojnë ndryshe. Normalisht, në buxhet plan të cekët edhe vlera në dollar edhe shuma ekuivalente në Euro.

- **Po pranohen, mirëpo për Ofertat në valuta tjera duhet të bashkangjesni kursin me të cilin është kalkuluar ndyshimi nga njëra valutë në tjetrën**

146. A duhet për marketing faturë

- **Po**

147. Nëse biznesi nuk ka arrit qarkullimin 7000 a kemi drejt aplikimi , biznesi ka fillu tm3 dhe është gastronomi

- **Po, shih Udhëzuesin e Skemës së Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“ PZHRB 2021 (Lot 1 Start-up dhe Lot 1 biznes ekzistues)**

148. Nëse biznesi deklaron me të ardhura reale a mund të aplikojë

- **Po**

149. A i pranon TVSH në fatura MZHR-ja? Apo duhet faturat të mirren nga furnitoret pa TVSH?

- **Po**

150. A mundeni mem tregu për këtë organin implementues një shembull?

- **Organi implementues varet prej aktiviteteve kush do ti realizojë gjatë zbatimit të projektit, mund të jetë vetë aplikanti apo furnizuesi i pajisjeve/shërbimeve.**

151. Nëse jemi bashkëpronar me një biznes a lejohet me apliku si Start-Up?

- **Startup është për bizneset ende të pa-regjistruara.**

152. Shembull i plotësimit të shtojcës së buxhetit

VII. BUXHETI

Fshije aplikimin

Buxheti për veprimin 1

Nr.	Shpenzimet	Njësia	Nr i njësive	Vlera e njësisë (në EUR)	Shpenzimet e përgjithshme me (në EUR)
1	Pajisjet/Makinëritë/Furnizimet				
1.1	Pajisja X	copë	1.00	16,800.00	16,800.00
1.2	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	0.00
<b>Totali 1</b>			1.00	16,800.00	16,800.00
- Fshij rresht + Shtu rresht					
2	Shpenzimet e nënkategorisë: Marketing, Trajnimë				
2.1	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	
2.2	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	0.00
<b>Totali 2</b>			0.00	0.00	0.00
- Fshij rresht + Shtu rresht					
3	Shpenzimet e nënkategorisë: të tjera				
3.1	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	Plotëso...	
<b>Totali 3</b>					
- Fshij rresht + Shtu rresht					
<b>Gjithësej shpenzime direkte të kualifikueshme për veprimin (1-3)</b>			1.00	16,800.00	16,800.00
2. Burimet e pritura të financimit dhe përmbledha e shpenzimeve të parapara					
	Shuma		Përqindja		
	EUR				
<b>Burimet e pritura të financimit</b>			%		
Kontributi i MZHR-së i kërkuar me këtë aplikacion (A)	15,000.00				
Kontributet tjera (bashkëfinancimi nga aplikanti)	1,800.00				
Kontributet totale të pritura (B)	16,800.00				
<b>Shpenzimet e parapara</b>					
Shpenzimet e përgjithshme të projektit të parapara (B)	16,800.00				
Kontributi nga MZHR e shprehur si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të kualifikueshme (A/B x 100)			89.29 %		
<b>Vlera totale e ofertës/ve për Pajisjet/makinëritë/shërbimet</b>	16,800.00				